



Pranuar / Dorezuar Punëdhëni/Prodator Received/Delivety	22.06.2023	3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednitca Org /Unit	Hi Prof Hi Prof Prof No	Shitja e Prteg Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SIKIMSHICK	4887/2023		17



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.672/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.672/2023 të datës 25.04.2023, të parashtruar nga ankuesi _____ të cilin me autorizim e përfaqëson avokat _____ me adresë _____ kundër Vendimit me Nr. 06/2023 të datës 14.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, në çështjen juridike “Masë Disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 , nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.06.2023, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET ankesa Anr.672/2022 e datës 25.04.2023, e parashtruar nga ankuesi _____ dhe **anulohet** Vendimi i Komisionit Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës me Nr.06/2023 i datës 14.04.2023 dhe çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë-Komisioni Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës.

II.OBLIGOHET Drejtori Ekzekutiv i Administratës Tatimore të Kosovës dhe Komisioni Disiplinor që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda 15 dite sipas pikës 1 nga dita e pranimit të tij.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ i punësuar në Administratën Tatimore të Kosovës, më datë 25.04.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokoli 3798/2023 në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me Nr. 06/2023 të datës 14.04.2023 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës për shkak të shkeljeve ligjore të dispozitave të Ligjit Nr.06/114 për Zyrtarët Publik, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 18.05.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Administrata Tatimore e Kosovës, ndërsa Këshilli më datë 22.05.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Administrata Tatimore e Kosovës, me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ka nxjerrë Vendimin me numër VK/2023 me datë 07.06.2023 sipas të cilit i është vazhduar afati ankesës së ankuesit edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 3798/2023 të datës 25.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Prova shtesë të datës 11.05.2023; E-mail nga për i datës 26.04.2023; E-mail nga për i datës 26.04.2023; E-mail nga për i datës 25.04.2023; E-mail nga për i datës 14.04.2023; E-mail nga për i datës 14.04.2023; E-mail nga për i datës 14.04.2023; Vendim me numër Nr.06/2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës i datës 14.04.2023; E-mail nga për i datës 04.04.2023; E-mail nga për i datës 04.04.2023; E-mail nga për i datës 03.04.2023; E-mail nga për i datës 03.04.2023; E-mail nga për i datës 30.03.2023; E-mail nga për i datës 30.03.2023; Akt Emërim i me numër AE. Nr. 07.2022 i datës 14.12.2022; Autorizim nga për i datës 05.04.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 18.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 22.05.2023; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 i datës 07.06.2023; Vendim për transferimin e nëpunësit civil për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit me numër protokolli 1885-01 i datës 09.12.2022; Formulari i përshkrimit të detyrave të punës; Shkresë përcjellëse për KD me numër 11-04 i datës 31.03.2023; Raportet e gjeneruara nga sistemi i vijueshmërisë në punë të ankuesit nga data 01.02.2023 deri 29.03.2023; Procesverbal i seancës të Komisionit Disiplinor i datës 12.04.2023; Urdhëresë e brendshme administrative mbi organizimin, mbikëqyrjen dhe masat për mosrespektim të orarit të punës nga stafi i Administratës Tatimore të Kosovës me numër protokolli 08-06-383 i datës 01.02.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në **rishqyrtim dhe rivendosje** te organi i njëjtë që ka vendosë në lidhje me masën disiplinore, **SEPSE:**

Nga administrimi i provave materiale të lëndës, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka gjetur se ankuesi në bazë të Akt Emërimit me numër AE.Nr.07/2022 të datës 14.12.2022 është i punësuar në pozitën "Drejtor i Departamentit Tatimor" Rajonal, në Gjilan.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Vendimi i Komisionit Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës me Nr.06/2023 i datës 14.04.2023 është nxjerrë me shkelje flagrante të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik dhe dispozitave të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Me datë 30.03.2023 Zv. Drejtori Ekzekutiv i ATK-së [] përmesë e-mailit zyrtar i është drejtuar Zëvendës Drejtorit Ekzekutiv 1 [] se: *bazuar në informatat e ndryshme që kam pranuar për Drejtorin e R. Gjilanit z. [] për mos prezencë të shpesht në vendin e tij të punës, unë kam kërkuar përmes personelit që nga IT-ja të nxjerret raporti mbi evidentimin e vijueshmërisë të këtij zyrtari. Nga raportet e bashkangjitura në attachment shihet se ka raste të shpeshta që Drejtori ka bërë klikim të hyrje-daljeve nëpër zyre të ndryshme jashtë objektit të Gjilanit! Andaj fillimisht kërkoj nga ju të analizoni nëse këto data ka kërkuar leje nga ju për lëvizje të tilla, nëse nuk ka kërkuar leje, a jeni njoftuar se në ato data ai nuk është në vendin e tij të punës nga ora 08:16! Sipas detyrës zyrtare që keni në mbikëqyrje të stafit që keni nën menaxhim, kërkoj nga ju të trajtoni këtë çështje, si dhe të procedoni me masat që duhet të ndërmerrni ju apo organet tjera brenda ATK-së!*

Ndërsa me datë 30.03.2023 Zëvendës Drejtori Ekzekutiv [] i është drejtuar me e-mail Divizionit të Burimeve Njerëzore të ATK-së, *pas analizimit të këtyre raporteve të gjeneruara nga sistemi i IT, për të cilat unë si mbikëqyrës nuk kam qenë i njoftuar nga zyrtari në fjalë lidhur me këto hyrje-dalje (jashtë vendit të punës në Gjilan), kërkoj nga ju që rastin ta referoni te komisioni disiplinor për trajtim dhe vendosje.*

Lidhur me këtë çështje Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të ATK-së ka përcjellë shkresën përcjellëse për Komisionin Disiplinor me arsyetimin se: *Ju njoftoj se divizioni BNJ me datë 30.03.2023 nga z. [] Zëvendës Drejtori Ekzekutiv 1, kërkesën për inicim të rastit ndaj z. [] Drejtor i Departamentit Tatimor Rajonal në Gjilan në Komision Disiplinor.*

Komisioni Disiplinor në Administratën Tatimore të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër Nr.06/2023 të datës 14.04.2023 ndaj ankuesit të cilin mbanë përgjegjësi për shkelje të rënda disiplinore të përsëritura, për shkak: të shkeljeve të dispozitave ligjore sipas nenit 46, paragrafi 3, nën paragrafi 3.5, 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik, të shkeljeve të rregullave sipas nenit 21 të rregullores (QRK) Nr.04/2015 për Kodin e Mirësjelljes në Shërbimin Civil të Kosovës, të shkeljeve të dispozitave sipas nenit 9, paragrafi 1,2,3,4 dhe 6 të Rregullores (QRK) Nr. 07/2022 për orarin e punës dhe pushimet e Zyrtarëve Publik, të shkeljeve të dispozitave sipas nenit 4, paragrafit 2 të Urdhëresës së Brendshme Administrative Nr. 080-06-383 të datës 01.02.2023 mbi organizimin, mbikëqyrjen dhe masat për mosrespektim të orarit të punës nga stafi i Administratës Tatimore të Kosovës, me ç' rast Komisioni Disiplinor ankuesit komfor nenit 48 paragrafi 3 në lidhje me nenin 47, paragrafin

1, 1.4 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarë Publik i ka shqiptuar masë disiplinore Largim nga puna në Administratën Tatimore të Kosovës.

Lidhur me vendimin e komisionit disiplinor Kolegji ka analizuar dispozitat e Ligjit nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë gjegjësisht nenin 25 ku përcaktohet se “ Detyrimi i respektimit të ligjit, mbrojtjes të interesit të shtetit dhe të drejtave të njeriut 1. Zyrtari publik detyrohet të respektojë Kushtetutën dhe ligjin dhe të mbrojë interesin e shtetit dhe të drejtat dhe liritë e njeriut. 2. Zyrtari publik ushtron detyrat e tij me profesionalizëm, paanësi, pa diskriminim, në kohë, pa interes personal dhe në përputhje me ligjin dhe kodin e etikës. 3. Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike”, prandaj nisur nga dispozitat e lartshënuara, Kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor i ATK-së nuk ka arritur të përcaktoj saktë se cilën shkelje e ka bërë ankuesi dhe nuk ka dhënë një përshkrim të saktë të dispozitave ligjore të cilat ankuesi me veprimet dhe mos veprimet e tij ka ra ndeshë me dispozitat ligjore në fuqi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave fillimisht ka analizuar Inicimin e procedurës disiplinore të datës 30.03.2023 nga Mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit ku me e-mail i drejtohet Divizionit të Burimeve Njerëzore të ATK-së me arsyetimin se: *pas analizimit të këtyre raporteve të gjeneruara nga sistemi i IT, për të cilat unë si mbikëqyrës nuk kam qenë i njoftuar nga zyrtari në fjalë lidhur me këto hyrje-dalje (jashtë vendit të punës në Gjilan), kërkoj nga ju që rastin ta referoni te komisioni disiplinor për trajtim dhe vendosje. Kolegji ka konstatuar se e njëjta është në kundërshtim me Rregulloren (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe ankesat e Zyrtarëve Publik konkretisht nenin 6 paragrafi 4 nën paragrafi 4.1, 4.2, 4.3 dhe 4.4 ku përcaktohet se: 4. Paraqitja e shkeljes disiplinore të pretenduar, sipas paragrafit 1 dhe 2 të këtij neni, duhet të i plotësojë këto kushte: 4.1. Kërkesa duhet të paraqitet në pajtim me LPPA-në. 4.2. Kurdo që është e mundur të identifikojë nëpunësin civil, i cili pretendohet se ka kryer shkeljen disiplinore. 4.3. Të përcaktojë veprimin konkret, që pretendohet se përbën shkelje disiplinore dhe rrethanat e kryerjes së tij, si dhe nenin 7 paragrafi 4 të po kësaj Rregulloreje e cila përcakton se: 4. Në rast se informacioni i marrë rezulton të ketë elemente si shkelje disiplinore, Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë bën kualifikimin e shkeljeve sipas nenit 46 të Ligjit.*

Në rastin konkret kërkesa për inicimin e procedurës disiplinore dhe as kualifikimi i saj nuk janë në pajtim me dispozitat ligjore materiale dhe procedurale konkretisht bazuar në nenin 52 paragrafi 1.3 dhe 1.5 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: *1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material;*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se bazuar në kërkesën për inicimin e procedurave në Komisionin Disiplinor të ATK-së nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejt i ankuesit, në preambulën e Vendimit me numër Nr. 06/2023 të Komisionit Disiplinor në ATK-së të datës 14.04.2023 shkruan se: *duke vepruar sipas kërkesës së zëvendësues zëvendës Drejtorit Ekzekutiv 1 në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, për inicim të procedurave disiplinore në cilësi të Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë, ndaj z. Drejtor Rajonal në Departamentin Tatimor*

Rajonal në Gjilan të cilin e ka pranuar me datë 31.03.2023, për shkak të supozimit të bazuar se ka kryer shkelje të përsëritura disiplinore të sanksionuara me nenin 46, paragrafin 3, nën paragrafin 3.5 3.6 dhe 3.8 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, Kolegji ka konstatuar se e njëjta nuk ishte e shkruar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me ç' rast komisioni merr rrolin e inicuesit duke e kualifikuar shkeljen pa qenë fare e kualifikuar në kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore me ç' rast Komisioni ka vepruar në kundërshtim me nenin 11 dhe 12 Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe ankesat e Zyrtarëve Publik.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore të ankuesit si dhe ligjshmërinë e Vendimit me Nr.06/2023 të datës 14.04.2022 të Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se në bazë të provave të lëndës, në seancën e parë të Komisionit Disiplinor të mbajtur më datë 12.04.2023 ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës që kanë të bëjnë me këtë rast dhe me datë 03.04.2023 është ftuar ankuesi që të marrë pjesë në cilësinë e palës në procedurë, i cili ka qenë me përfaqësuesin e autorizuar, ndërsa inicuesi i procedurës disiplinore, eprori i ankuesit nuk është ftuar që të marrë pjesë në seancë të komisionit disiplinorë përkundër që ka inicuar rastin në komision disiplinor.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave duke ju referuar shkresave të lëndës bazuar në nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafin 3.3 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë, i cili përcakton se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: "Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, në këtë rast Kolegji i Këshillit, konstaton se mospjesëmarrja e inicuesit të procedurës disiplinore si rezultat i mungesës së ftesës për të njëjtin paraqet shkelje të kësaj dispozite për faktin që pa marrë parasysh kërkesën për iniciimin e procedurës disiplinore inicuesi i procedurës disiplinore duhet të ftohet në seancë të komisionit disiplinor dhe përveç kësaj, duhet të jenë njëkohësisht në seancë bashkë me nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore me qëllim që të paraqesin argumentet e tyre me qëllim të ballafaqimit të fakteve, nga se kjo dispozitë është e karakterit imperativ dhe nuk i lihet në diskrecion komisionit disiplinor të vlerësoj sa i përket çështjes së prezencës së inicuesit të rastit në komision disiplinor, andaj mbi këtë elementë konstatohet se mungesa e ftesës dhe si rezultat i saj edhe mos prezenca e inicuesit të procedurës disiplinore në lidhje me ankuesin në komision disiplinor me qëllim të ballafaqimit të fakteve paraqet shkelje të dispozitave ligjore procedurale që rregullojnë këtë aspekt dhe që u specifikuan më lartë.

Po ashtu Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj ankuesit nuk ka marrë parasysh për bazë përcaktimin ligjor në nenin 50 paragrafin 1 nën paragrafi 1.3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Për përcaktimin e masës disiplinore të zbatueshme, mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë ose komisioni disiplinor bazohet në ekzistencën e masave të tjera disiplinore të mëparshme të pashlyera, sipas nenit 47 të këtij ligji"*, ngase ankuesi sipas shkresave të lëndës del se nuk ka një masë aktive apo të shqiptuar për shkelje disiplinore, ndërsa Komisioni Disiplinor ka shqiptuar drejtpërdrejtë masën më të rëndë disiplinore në Shërbimin Civil *"Largim nga Puna në Shërbimin Civil"*.

Po ashtu referuar shkresave të lëndës dhe duke marrë për bazë Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, konkretisht neni 47, ka përcaktuar se: *“Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 1.1. vërejtje; 1.2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil”*.

Andaj, bazuar në konstatimet e mësipërme dhe duke marrë për bazë shkresat e lëndës, kolegji i këshillit konstaton se Komisioni Disiplinorë me rastin e shqyrtimit të rastit të ankuesit përkatësisht shqiptimin e masës disiplinore nuk ka arritur të konstatoj saktë elementet e përgjegjësisë disiplinore siç parashihet me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, rrjedhimisht Vendimi me Nr.06/2023 i datës 14.04.2023 i Komisionit Disiplinor i Administratës Tatimore të Kosovës, nuk përmban dispozitiv të qartë, po ashtu edhe arsytimi është kundërthënës siç parashihet me nenin 48 paragrafi 1, nën paragrafi 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të nenit 52 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ndërsa arsytimi i tij është në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 48 të këtij ligji, i cili parasheh se: *“Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij”*.

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, konstaton se Vendimi me Nr.06/2023 i datës 14.04.2023 i Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale dhe dispozitave materiale, atëherë i njëjti sipas Kolegjit të Këshillit është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që në kuptim të dispozitave ligjore të zbatueshme të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë dhe Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Komisioni Disiplinor i ATK-së është i obliguar që të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe në riprocedurë të mënjanojë shkeljet procedurale dhe të veprojnë komformë dispozitave të ligjit material, dhe të rishqyrtoj rastin e ankuesit në pajtim me legjislacionin në fuqi, duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e rastit si dhe duke marrë parasysh përveç tjerash edhe nenin 13 paragrafi 4 dhe 5 të Rregullores (QRK) Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë.

Duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për shqyrtimin e ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.


Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh,

nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.672/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- *Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit avokatit*
- *Drejtorit Ekzekutiv të Administratës Tatimore të Kosovës ;*
- *Komisionit Disiplinor të Administratës Tatimore të Kosovës;*
- *Udhëheqësit të Personelit të Administratës Tatimore të Kosovës dhe*
- *Arkivit të KPMSHCK- së;*